


Përqindja e fëmijëve 0-18 vjeç me aftësi të kufizuar



Shënim: Të dhënat “Përqindja e fëmijëve që jetojnë pa ujë të përmirësuar të pijshëm, energji elektrike, që jetojnë në banesa të papërshtatshme dhe përqindja e fëmijëve me 1 ose 2 prindër të pa punë”, - janë marrë nga studimi i thelluar me autorë A. Ceni dhe V. Kolpeja.


OBSERVATORI PËR TË DREJTAT E FËMIJËVE QARKU TIRANË



Qarku i Tiranës ka një popullsi prej 997,380 banorë¹. Ai përbëhet nga Rethi Tiranë dhe Kavajë me 29 Komuna dhe Bashki përkatësisht: 5 Bashki dhe 24 Komuna. Qyteti i Tiranës është qyteti më i rëndësishëm jo vetëm në qarkun e Tiranës, por edhe në vend. Ai është në të njëjtën kohë qendra e Prefekturës dhe e Qarkut Tiranë por edhe kryeqyteti i Shqipërisë.

Qyteti i Tiranës u themelua në vitin 1614 nga Sulejman Pashë Bargjini, me origjinë nga fshati Mullet.

¹ Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, Ministria e Brendshme, Mars 2011





Në 9 Shkurt të vitit 1920, në Kongresin e Lushnjes, rrethi i Tiranës u shpall kryeqytet i përkohshëm i Shqipërisë. Në vitin 1925 Asambleja Kushtetuese e shpalli përfundimisht kryeqytet të Shqipërisë.

Qarku i Tiranës, kufizohet në veri me Qarkun e Durrësit, në verilindje me Qarkun e Dibrës, në juglindje me Qarkun e Elbasanit, në jug me Qarkun e Fierit dhe në perëndim me Detin Adriatik.



Qarku i Tiranës ka një sipërfaqe prej 1652¹ km² dhe një popullsi prej 997,380² banorë (2010). Numri i familjeve për Qarkun e Tiranës është 135,882³ ndërsa grupmosha 0-18 vjeç përbën 27% të popullsisë ose 265,873⁴ banorë.

Qyteti i Tiranës është qendra më e madhe ekonomike, administrative, politike, industriale, mediale, akademike, sociale dhe kulturore e vendit.



Më shumë informacion rreth qarkut mund të gjeni në faqen: <http://www.qarkutirane.gov.al>

Përshkrim mbi situatën e të drejtave të fëmijëve në Qark:

Qarku i Tiranës në vitin 2010, ka 997.380⁶ banorë dhe 135,882⁷ familje në total. Nga numri total i familjeve në qark, 7,542 familje (7.03%) janë familje të varfra dhe kanë fëmijë (grupmosha 0-15 vjeç). Fëmijët (0-18 vjeç) përbën 26.7 % të popullsisë (265.873 fëmijë).



Në vitin 2010 në Qarku e Tiranës 1 në 22 fëmijë (6,575 fëmijë) të grupmoshës 6-15 vjeç jeton në familje e cila trajtohet me Ndihmë Ekonomike (NE).



Komunat me përqindjen më të lartë të familjeve përfituese të Ndihmës Ekonomike në Qarkun Tiranë, janë: Paskuqan (82%), Vaqarr (69%), Sinaballaj (22%), Krrabë (13%), Kavajë (12%), etj.

6 Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, Ministria e Brendshme, Mars 2011
7 Burimi: Shërbimi Social Shtetëror, Tiranë (Prill 2011)

1 INSTAT shih Instituti i Statistikave (2007), *Tregues sipas Qarqeve*, Tiranë

2 Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, Ministria e Brendshme (2011)



3 Shërbimi Social Shtetëror Tiranë (2011)

4 Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, Ministria e Brendshme (2011)

Komunat që kanë numër të lartë të fëmijëve që (6-15 vjeç) që jetojnë në familje me NE, janë: Shën Gjergji (35%), Pezë (18%), etj.

Nga të dhënat figuron se Qarku i Tiranës, megjithëse është një ndër qarqet më të mëdha në territorin e Shqipërisë dhe me një numër popullsie të lartë, ka një përqindje të ulët të fëmijëve me aftësi të kufizuar. Në Qarkun e Tiranës, për vitin 2010 janë 3.049 fëmijë të moshës 0-18 vjeç me aftësi të kufizuar (PAK)⁸, ose 1.1% të fëmijëve. Nëse krahasojmë numrin e fëmijëve që jetojnë në zonë urbane me ato në zonë rurale, rezulton se 2169 (71%) jetojnë në qytet dhe 880 fëmijë (29%) me aftësi të kufizuar Sigurimi dhe ofrimi i shërbimeve bazë për këtë grup fëmijësh vazhdon të mbetet në kuadër të politikave sociale si në nivel bashkie, minibashkie dhe komune. Një numër i madh i fëmijëve me aftësi të kufizuara marrin shërbim të kualifikuar në qendrat dhe institucionet që ofrojnë këto shërbime në Qarkun e Tiranës.

Në Qarkun e Tiranës, komunat që kanë numrin më të lartë të fëmijëve me aftësi të kufizuar (0-18 vjeç) janë: Zallbazar (2,6 %) ose 50 fëmijë, Paskuqan (2,3 %) ose 38 fëmijë, Kamëz (1,8 %) ose 484 fëmijë, Dajt (1,5%) ose 54 fëmijë.



Observatori për të drejtat e fëmijës është një strukturë vëzhguese e shoqërisë civile e ngritur në qarkun e Tiranës në vitin 2009, e cila në bashkëpunim të ngushtë me të gjithë aktorët vendorë publikë e jo-publikë bën mbledhjen sistematike të të dhënave dhe përgatit raporte dhe informacione periodike për aktorët

⁸ Burimi: Shërbimi Social Shtetëror, Tiranë (Prill 2011)



lokalë dhe kombëtarë lidhur me situatën e fëmijëve, shkeljen e të drejtave, zbatimin e legjislacionit në fuqi dhe nevojat për përmirësimin e tij të mëtejshëm.

*Observatori për të drejtat e Fëmijëve, Qarku Tiranë gjendet në Bulevardi " Bajram Curri " , Pallatet Agimi, Shkalla 5, Ap. 81.
Tiranë, Shqipëri
e-mail: observatori_dr@yahoo.com
URL: www.observator.org.al*





Politika Rajonale në ndikojnë në realizimin e të drejtave të fëmijëve

Qarku i Tiranës është në proces hartimi dhe përgatitje për herë të parë të "Strategjisë për të Drejtat e Fëmijëve" (informacion i marrë nga zyra e Këshillit të Qarkut, Gusht 2012).



Në dobi të realizimit dhe përmbushjes të të drejtave të fëmijëve, në Qarkun Tiranë, veç zyrës së Observatorit, është ngritur dhe funksionon Njësia për të Drejtat e Fëmijëve” në Qark.



Përqindja e fëmijëve 6-15 vjeç që jetojnë në familje të cilat mbështeten me NE

